



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. 3108 / \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2023

**Shtojca 12**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Data: \_\_\_\_\_ 2023

Drejtuar: **OE “Palma Construction” Sh.p.k.**, me NIPT K66607001U dhe me adresë Tiranë, Rruga Myslym Shyri, Ndërtesa nr.51, nr.ap 27.

\* \* \*

Procedura e prokurimit/lotit: **-e hapur e thjeshtuar - shërbime.**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-79162-09-06-2023**

**Lot1- REF-79165-09-06-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Supervizim për rikonstruksionin e qendrave shëndetësore (viti 2023-2024)”** me fond limit **2,603,903.57** (dy milion e gjashtëqind e tre mijë e nëntëqind e tre.57) **Lekë pa TVSH**, ndarë në lote:

- **Lot.1 “Supervizim për rikonstruksionin e disa QSH- ve në qarqet Berat, Korçë dhe Elbasan”** me fond limit **775,525.53** (shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzetë e pesë.53) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: Lot 1 – 180 dite nga data e nenshkrimit te proces-verbalit të fillimit te punimeve (per objektin e pare).

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Po - Buletini Nr. 62 datë 17 Korrik 2023.

Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 77 datë 11 Shtator 2023.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- **Lot.1 “Supervizim për rikonstruksionin e disa QSH- ve në qarqet Berat, Korçë dhe Elbasan”** me fond limit **775,525.53** (shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzetë e pesë.53) **lekë pa TVSH**;

<b>1</b>	OE “Palma Construction” Sh.p.k., me NIPT K66607001U dhe me adresë Tiranë, Rruga Myslym Shyri, Ndërtesa nr.51, nr.ap 27 - ofertuar me vlerë 614,313.29 lekë pa TVSH.
----------	---

2	OE "MCE" Sh.p.k., me NIPT L72203065K dhe me adresë Tiranë, Rruga "Kavajës", Qendra "Sun Tower", Kati 9, Ap.38 - ofertuar me vlerë 614,315 lekë pa TVSH.
3	OE "ARKIMADE" Sh.p.k., me NIPT L01906030A dhe me adresë Tiranë, Rruga "Him Kolli", Ndërtesa Nr.24, Hyrja Nr.9 - ofertuar me vlerë 617,650 lekë pa TVSH.
4	OE "Miki Consulting" Sh.p.k., me NIPT K87628701K dhe me adresë Shkodër, Lagjja Vasil Shanto, Rruga Vaso Kadia, godine nr 1/506 - ofertuar me vlerë 620,490.82 lekë pa TVSH.
5	OE "GB Civil Engineering" Sh.p.k., me NIPT L51825011V dhe me adresë Tiranë, Rruga e Kavajës, ish-Parku, pranë "Tregut 100 Vitrinat", Kulla C, Shkalle 2 - ofertuar me vlerë 649,260.57 lekë pa TVSH.
6	BOE "HYDRO-ENG CONSULTING" Sh.p.k., dhe "P.C.S. COMPANY" Sh.p.k., me përfaqësues të këtij bashkimi OE "HYDRO-ENG CONSULTING" Sh.p.k.: "HYDRO-ENG CONSULTING" Sh.p.k., me NIPT M11417503F dhe me adresë Durrës, Rruga Ahmet Ramzoti, Lagjja nr.18, Rajoni nr.5, nr.Pasurie 29/70+1-211, Zona kadastrale 8511 dhe "P.C.S. COMPANY" Sh.p.k., me NIPT K91527021J dhe me adresë Tiranë, Kompleksi Garden Residence Turdiu, Kulla B, Zyra 211/3, Rruga Andrea Kushi nr.58, Al 1023 - ofertuar me vlerë 658,040 lekë pa TVSH.
7	OE "G&L Construction" Sh.p.k., me NIPT L61901013N dhe me adresë Tiranë, Njesia Bashkiake Nr.6, Rruga e Qelqit, Pallatet e firmes Derveni, Kulla 8, Njesia nr.4, Kombinat - ofertuar me vlerë 677,809 lekë pa TVSH.
8	BOE "DAAM" Sh.p.k., dhe "NET-GROUP" Sh.p.k., me përfaqësues të këtij bashkimi OE "DAAM" Sh.p.k.: "DAAM" Sh.p.k., me NIPT L72205042F dhe me adresë Tiranë, Rruga Haxhi Dalliu, Hyrja 1, Apartamenti 0 dhe "NET-GROUP" Sh.p.k., me NIPT L72023002P dhe me adresë Tiranë, Mangull, Zona Kadastrale 3975, Numer Pasurie 80/2 - ofertuar me vlerë 689,438.68 lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**I. Lot.1 "Supervizim për rikonstruksionin e disa QSH- ve në qarqet Berat, Korçë dhe Elbasan"**

1. OE "MCE" Sh.p.k., me NIPT L72203065K dhe me adresë Tiranë, Rruga "Kavajës", Qendra "Sun Tower", Kati 9, Ap.38 - ofertuar me vlerë 614,315 lekë pa TVSH.

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky operator ekonomik ka rezultuar si më poshtë:

OE MCE Sh.p.k., ka dorëzuar një deklaratë nga shoqëria "PROGREEN" Sh.p.k., ku deklorohet si më poshtë:

*Unë e nënshkruara Sonila Ukperaj me cilësinë e Administratorit të operatorit ekonomik "PROGREEN" Sh.p.k deklaroj se: Në cilësinë e subjektit në kapacitetet e të cilit do të mbështetet operatori ekonomik "MCE" sh.p.k, si pjesëmarrës në tenderin me të dhënat e sipërpërmendura nuk kam arsye për skualifikimin ose përjashtimin nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe do të ve në dispozicion punonjësit e mëposhtëm :*

*4. Z. Dritan KORBI me profesion Ing.Ndertimi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, do të angazhohet në zbatimin e këtij projekti në rast se shoqëria "MCE" sh.p.k do të shpallet fituese.*

Gjithashtu në dokumentat e ngarkuara në SPE nga OE "MCE" Shpk., rezulton të jetë dorëzuar Shtojca 9 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit i shoqërisë "PROGREEN" Sh.p.k., ku

deklarohet Z. Dritan Korbi - Inxhinier Ndërtimi, në përmbushje të kriterit të kualifikimit të mëposhtëm:

**2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë (jo drejtues teknik) inxhinierin e ndërtimit, që do të jetë në kantier (në rolin e supervisorit) sipas grafikut të punimeve:**

**1 inxh.ndërtimi**

Per këtë inxhinier, duhet të paraqiten kontrata e punës brenda afatit të vlefshmerisë së këtij objekti, diploma dhe cv.

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.**

Shënim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Ndërkohë, sqarojmë se në pikën 2.16 të Seksioni 1: Autoriteti Kontraktor, të DST, parashikohet:

**2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:**

Specifikoni nëse autoriteti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po



Jo

X

**Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:**

---

Pra, siç është përcaktuar në DST, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi nuk mund të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit.

Sa më lart, OE “MCE” Sh.p.k., nuk ka dorëzuar asnjë dokument provues për përmbushjen e kriterit të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.5 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të Shtojcës 8.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi **ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.**

2. OE “Miki Consulting” Sh.p.k., me NIPT K87628701K dhe me adresë Shkodër, Lagjia Vasil Shanto, Rruga Vaso Kadia, godine nr 1/506 - ofertuar me vlerë 620,490.82 lekë pa TVSH.

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

Lidhur me dokumentacionin e dorëzuar për Kriteret e Veçanta të Kualifikimit resulton se në DST, Shtojca 8, pika 2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit Loti 1” është kërkuar:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*b Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE “Miki Consulting” Sh.p.k., lidhur me Formularin e Sigurimit të Ofertës të paraqitur, ka rezultuar se **“sigurimi i ofertës është i vlefshëm për 150 ditë”**.

Në DST përcaktohet: 3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 180 (njëqindetëdhjetë) (shprehur në ditë)

Në pikën 3 të nenit 30 “Sigurimi i ofertës” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

*3. Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. **Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.***

Përsa më sipër, resulton se OE nuk e ka paraqitur Formularin e Sigurimit të Ofertës në përputhje me përcaktimet e kërkuara në DST.

3. OE “GB Civil Engineering” Sh.p.k., me NIPT L51825011V dhe me adresë Tiranë, Rruga e Kavajës, ish-Parku, pranë "Tregut 100 Vitrinat", Kulla C, Shkalle 2 - ofertuar me vlerë 649,260.57 lekë pa TVSH.

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

Lidhur me dokumentacionin e dorëzuar për Kriteret e Veçanta të Kualifikimit resulton se në DST, Shtojca 8, pika 2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit Loti 1” është kërkuar:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*b Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE “GB Civil Engineering” Sh.p.k., lidhur me Formularin e Sigurimit të Ofertës të paraqitur, ka rezultuar se **“sigurimi i ofertës është i vlefshëm për 150 ditë”**.

Në DST përcaktohet: 3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 180 (njëqindetëdhjetë) (shprehur në ditë)

Në pikën 3 të nenit 30 “Sigurimi i ofertës” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

3. Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. **Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.**

Përsa më sipër, rezulton se OE nuk e ka paraqitur Formularin e Sigurimit të Ofertës në përputhje me përcaktimet e kërkuara në DST.

4. OE “G&L Construction” Sh.p.k., me NIPT L61901013N dhe me adresë Tiranë, Njesia Bashkiake Nr.6, Rruga e Qelqit, Pallatet e firmes Derveni, Kulla 8, Njesia nr.4, Kombinat - ofertuar me vlerë 677,809 lekë pa TVSH.

#### **Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

Në pikën 2.3.3 të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, të Shtojcës 8 të DST (Për Lotin 1), parashikohet:

**2.3.3 Shoqeria duhet të paraqesë Certifikatat e cilësisë si më poshtë:**

- a. *Certifikatën e cilësisë së punimeve ISO 9001-2015 (e vlefshme)/ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
- b. *Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme). /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
- c. *Certifikatën ISO 45001:2018 (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë) ose ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

***Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave të që merr përsipër të realizojë në akt marrëveshje.***

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE “G&L Construction” Sh.p.k., ka rezultuar se Certifikata **ISO 45001:2018 ka skaduar më datë 19/07/2023.**

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi **ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.**

5. BOE “DAAM” Sh.p.k., dhe “NET-GROUP” Sh.p.k., me përfaqësues të këtij bashkimi OE “DAAM” Sh.p.k.: “DAAM” Sh.p.k., me NIPT L72205042F dhe me adresë Tiranë, Rruga Haxhi Dalliu, Hyrja 1, Apartamenti 0 dhe “NET-GROUP” Sh.p.k., me NIPT L72023002P dhe me adresë Tiranë, Mangull, Zona Kadastrale 3975, Numer Pasurie 80/2 - ofertuar me vlerë 689,438.68 lekë pa TVSH.

#### **Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**



BOE "DAAM" Sh.p.k., dhe "NET-GROUP" Sh.p.k., ka paraqitur Kontratën e Bashkëpunimit lidhur më datë 16.09.2023, ku në nenin 4 të saj përcaktohet pjesëmarrja e operatorëve në këtë bashkim, si më poshtë:

Pjesëmarrja e palëve në përqindje në bashkëpunim:

- Shoqëria "DAAM" Sh.p.k., 65% në pjesëmarrje,
- Shoqëria "NET-GROUP" Sh.p.k., 35% në pjesëmarrje.

Përfaqësuesi në këtë bashkëpunim është Operatori Ekonomik "DAAM" Sh.p.k.

*Në pikën 4.2 të nenit 4 të Kontratës së Bashkëpunimit mes palëve përcaktohet si më poshtë:*

*Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike do të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, apo fokusit kryesor të secilit anëtar, të përcaktuara në Akt Marrëveshje.*

Sa më lart, në pikën 2.3.1 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, të Shtojcës 8 të DST (Për Lotin 1), kërkohet:

**2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit të Lotit 1 që prokurohet, të realizuara gjatë tri viteve të fundit, nga data e njoftimit të kontratës së shpallur.**

*a) Kur kontrata është realizuar me institucione shtetërore, ofertuesi duhet të paraqesë **kontraten e nenshkuar, vërtetim për realizimin me sukses nga institucioni me të cilin është lidhur kontrata te shoqeruar me faturen tatimore.***

*b) Kur kontratat janë të realizuara me subjekte private ofertuesi duhet të paraqesë **kontraten e nenshkuar dhe faturat tatimore** ku të jene shënuar datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

Në përmbushje të këtij kriteri OE DAAM Shpk ka paraqitur kontratat e mëposhtme:

- Kontratë Shërbimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor Nr. 13378 Prot., datë 09.07.2021 me objekt "Mbikëqyrje e punimeve të investimit me objekt "Mobilim Urban, Sistemim Sheshi, Ndricim për DRSHTRR Tiranë", fatura dhe formular vlerësimi;
- Kontratë Shërbimi me Bashkinë Dimal Nr. 23/9 Prot., datë 11.10.2021 me objekt "Mbikëqyrje për objektin: "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pafavorizuara" dhe Kolaudim punimesh për objektin: "Rikonstruksion i ish kinemasë Poshnje" REF-07146-10-04-2021", fatura dhe formular vlerësimi;
- Kontratë Shërbimi me "YDA Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi Dega Shqipëri" Shpk., e datës 22.01.2021 me objekt "Shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve dhe konsulencës inxhinierike në realizimin e punimeve të zbatimit për ndërtimin e Spitalit Memorial Rajonal Fier", së bashku me letër reference;
- Kontratë mbikëqyrje punimesh me Ujësjiellës Kanalizime Kamëz Sh.a. Nr. 462 Prot., datë 09.04.2021 me objekt "Mbikëqyrje punimesh për objektin "Ndërtim linjë e re në tubacionin d=700mm të Bovillës së vjetër, L=6.0 km (Zëvendësimi i tubacionit ekzistues-hekuri nga ligjeni i Zall-Herr deri tek "Kafja e Remës"", fatura dhe Akt-Kolaudimi;

- Kontratë Shërbimi për Kolaudim punimesh ndërtimi me Bashkinë Tiranë Nr. 24902/1 Prot., datë 24.06.2021 me objekt "Ndërtimi i terreneve sportive në shkollën 9-vjecare "Kosova"", fatura dhe referencë për kryerje shërbimi konsulence;
- Kontratë Shërbimi për Kolaudim punimesh ndërtimi me Bashkinë Tiranë Nr. 43460/2 Prot., datë 19.11.2021 me objekt "Ndërtimi i Shkollën 9-vjecare "Qazim Turdiu", fatura dhe referencë për kryerje shërbimi konsulence;
- Kontratë Shërbimi për Kolaudim punimesh ndërtimi me Bashkinë Tiranë Nr. 48543/2 Prot., datë 20.12.2021 me objekt "Ndërtimi i Shkollën cikli i ulët "Pajan", fatura dhe referencë për kryerje shërbimi konsulence;
- Kontratë Shërbimi për Kolaudim punimesh ndërtimi me Bashkinë Tiranë Nr. 22885/2 datë 17.06.2021 me objekt "Ndërhyrje rehabilituese në rrugën "Tom Plezha", fatura dhe referencë për kryerje shërbimi konsulence;
- Kontratë Shërbimi për Kolaudim punimesh ndërtimi me Bashkinë Tiranë Nr. 33964/2 datë 24.09.2021 me objekt "Ndërtimi i Godinës Qendra Sociale "Të qëndrojmë së bashku" Kombinat", fatura dhe referencë për kryerje shërbimi konsulence;
- Kontratë Shërbimi për Kolaudim punimesh ndërtimi me Bashkinë Tiranë Nr. 28294/2 datë 03.08.2021 me objekt "Rehabilitimi i rrugëve të bllokut që kufizohet nga rrugët "Fabrika Qelqit", "Konferenca e Pezës", "Besim Alla" dhe "Jorgo Panajoti" - Faza I", fatura dhe referencë për kryerje shërbimi konsulence;
- Kontratë Shërbimi për Kolaudim punimesh ndërtimi me Bashkinë Tiranë Nr. 25871/2 datë 08.07.2021 me objekt "Rindërtimi i banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike si dhe cdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja, për zhvillim në Njësinë Administrative Kashar 15 shtëpi"", fatura dhe referencë për kryerje shërbimi konsulence;
- Kontratë Shërbimi për Kolaudim punimesh ndërtimi me Bashkinë Tiranë Nr. 24937/2 datë 08.07.2021 me objekt "Rindërtimi i banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike si dhe cdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja, për zhvillim në Njësinë Administrative Baldushk 23 shtëpi"", fatura dhe referencë për kryerje shërbimi konsulence;

Nga kontratat e dorëzuara nga OE "DAAM" Shpk., sic janë listuar më sipër, rezulton se objekti i kontratave të mësipërme nuk është i ngjashëm me objektin e kërkuar në DST nga AK.

Sa më lart, në vijim të praktikës së Komisionit të Prokurimit Publik, përsa i përket përvojës së ngjashme sqarohet se:

*Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit*

me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

- Si kontratë e ngjashme do të konsiderohet vetëm Kontrata e Shërbimit me Bashkinë Dimal Nr. 23/9 Prot., datë 11.10.2021 me objekt "Mbikëqyrje për objektin: "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pafavorizuara" dhe Kolaudim punimesh për objektin: "Rikonstruksion i ish kinemasë Poshnje" REF-07146-10-04-2021", duke konsideruar shërbime të ngjashme vetëm "Mbikëqyrje për objektin: "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pafavorizuara". Gjithësesi, edhe në këtë rast nuk plotësohet vlera sipas përqindjes në bashkëpunim të këtyre operatorëve (sipas faturave të dorëzuara nga ky operator), për plotësimin e kriterit të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të kriterëve të veçanta të kualifikimit të DST.
- Ndërsa lidhur me kontratën e realizuar me shoqërinë "YDA Insaat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi Dega Shqipëri" Shpk., nuk ka faturë bashkëlidhur kësaj kontrate, pasi sipas një letër reference nga kjo shoqëri si dhe kontratës së lidhur mes palëve, sqarohet se kjo kontratë do të ofrohet falas nga ana e BOE "NET-GROUP" shpk dhe "DAAM" shpk.

Me qëllim mbajtjen e një standarti në vlerësim për të gjithë operatorët ekonomik që kanë dorëzuar oferta në këtë procedurë prokurimi, lidhur me plotësimin e kriterit të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të DST, ku për kontratat e lidhura me subjektet private kërkohet **kontrata e nënshkruar dhe faturat tatimore** ku të jenë shënuar datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, KVO arrin në përfundimin se ky BOE nuk plotëson kriterin e kërkuar në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjen në bashkim, sipas kontratës së bashkëpunimit.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë:

- **Lot.1 "Supervizim për për rikonstruksionin e disa QSH- ve në qarqet Berat, Korçë dhe Elbasan"** me fond limit 775,525.53 (shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzetë e pesë.53) lekë pa TVSH:

**1.** OE "Palma Construction" Sh.p.k., me NIPT K66607001U dhe me adresë Tiranë, Rruga Myslym Shyri, Ndërtesa nr.51, nr.ap 27, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **614,313.29** [gjashtëqind e katërmëdhjetë mijë e treqind e trembëdhjetë.29] **lekë pa TVSH** / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *AK/MSHMS me adresë Rruga e Kavajës Nr 1001 Tiranë - Drejtoria e Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është



dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**MEJVIS KOLA**